

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE
TE LINJES PER PRODHIM KOLLI, STUKO, FINO (TE LLACEVE TE THATE DHE
BOJRAVE), MATERIALE HIDROIZOLUESE, PER SUBJEKTIN “GRANTIS” SH.P.K.
PRODHIM MATERIALE NDERTIMI , NE ISH KOMBINATIN METALURGJIK



KOMUNA BRADASHESH

INVESTITOR ISA HYKA

Hartoi VNM-ne
Studio “Elbasani”
Eksperti Mjedisor
Ing. Lila Karaj

PERMBAJTJA

1-HYRJE

2-KUADRIT LIGJOR

3-TE DHENA TE PERGJITHSHME PER SHOQERINE

4- PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE-LENDET E PARA

5-NDIKIMET E MUNDESHME NE MJEDIS DHE MASAT E PROPOZUARA PER
PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE

6- PROGRAMI I MONITORIMIT

-REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

1 – HYRJE

Ne zhvillimin ekonomik-shoqeror te nje vendi, gjithenje ne perputhje me parimet universale te zhvillimit te qendrueshem, marrin nje rendesi te vecante gjetja e rrugeve me efikase prodhimi i materialeve te gateshme ndertimore. Gjate dekadave te fundit veprimtari te ndryshme kane ndikuar dukshem ne mjedisin rrethues ne pergjithesi. Ndryshimet e sistemit te zhvillimit ekonomik te vendit duke u orientuar drejt ekonomise se tregut ka bere qe konsumatori te kerkoje me shume cilesi produkti dhe kulture sherbimi.

Vendi yne eshte antare i nje numri konventash nderkombetare si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoje nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomike -sociale-mjedisore dhe per rregullimin e territorit, sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore. Mjedisi eshte burim i gjithcekaje per te cilen njerzit kane nevojte per te jetuar dhe per tu zhvilluar. Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik -social. Prandaj duhet nje menaxhim sa me i mire i mjedisit natyror ne lidhje me aktivitetin njerezor qe po zhvillohet cdo dite e me shume. Ne Shqiperi, zhvillimi i veprimtarise ekonomike dhe tranzicjoni i veshtire drejt ekonomise se tregut ka ushtruar trusni te forte ne mjedis duke ndikuar negativisht ne te. Investimet e reja kane sjelle ndikime ne mjedis, por tashme eshte arritur qe shume prej veprimtarive qe ushtrojne aktivitet brenda territorit te Republikes se Shqiperise ti nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis perpara miratimit dhe zbatimit te tyre si qellim per te parandaluar krijimin e zonave te tjera te ndotura. Ky qellim eshte kaq i rendesishem saqe theksojme qe parandalimi eshte edhe me i mire edhe me pak i kushtueshem se sa kurimi.

Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) .

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situate normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne cdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i vecante i kushtohet praktikave te V.N.M. per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara;
- Te promovojte zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis .

Zhvillimi i Qendrueshem eshte nje koncept kyç qe ka marre nje perhapje dhe pranim nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Agjenda 21, dhe plani global per zhvillimin e qendrueshem theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit dhe promiovimin e V.N.M. dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

2. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Pergatitja e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te aktivitetit te propozuar eshte kryer duke u bazuar ne aktet ligjore te meposhteme:

Ligji Nr 10431, date 9.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit” ;

Ligji Nr.10448, date 14.07.2011, ”Per Lejet e Mjedisit”;

Ligji Nr. 10 440, date 7.7.2011 "Per Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis" ;
Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të Mbetjeve të Ngurta";
Ligji Nr 9115, date 27.02.2003 "Per trajtimin mjedisor te ujrave te ndotur". te ndryshuar dhe aktet
nenligjore qe rrjedhin prej tij;
Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis".
Ligji Nr. 9108, date 17.07.2003, " Per substancat dhe preparatet kimike";
Ligji Nr.9097, date 03.07.2003, "Per vleresimin e konformitetit";
Ligji Nr.7819, date 27.04.1994, "Per pronesine industriale";
Ligji Nr.9290, date 07.10.2004, "Per produktet e ndertimit";
VKM. Nr 249 date 24.04.2003 "Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te
elementeve te lejes mjedisore";
VKM. Nr. 1189, date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit
kombetar te monitorimit te mjedisit";
VKM. Nr. 177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengta dhe kriteret e zonimit
te mjedisve ujore pritesë";
VKM. Nr. 435, date 12.09.2002 "Per normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise";
V.K.M.Nr.587, date 07.07.2010, "Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat
urbane dhe turistike";
Udhezim Nr 8, date 27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedis te caktuar.

3. TE DHENA TE PERGJITHSHME PER SHOQERINE

Emerti : "GRANITIS" SH.P.K.

Selia : Rrethi Elbasan, Komuna Bradashesh, ish kombinati metalurgjik

Aktiviteti: Fabrike prodhimi kolli, stuko, fino(prodhim llacrash te thata), ngjyruesh. Krahas saj
subjekti ka aktivitetet te tjera si grumbullim dhe perpunim skrapi etj

Admnostraor : Isa HYKA

4. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE

Vendodhja e objektit. Objekti i prodhimit te kollit, stukos, finos dhe ngjyruesve per te cilin hartohet
studimi dhe kerkohet leja mjedisore ndodhet ne territorin e Komunes Bradasheshte, Rrethi Elbasan.

Objekti ndodhet ne zonen kadastrale 3965, Nr.pasurise 941 Indeksi hartes EL; F-9, F-10,G-9, G-10;
kufizimet: V-Nr. Pasurise 858/1; L - Nr. Pasurise 860; J- Nr. Pasurise 860; P- Nr. Pasurise 858/1; 388.

Siperfaqe trualli 4000m²; siperfaqe ndertimi 316m²; Siperfaqe objekteve ekzistuese 960m².

Objekti per ndertim eshte miratuar me vendim Nr.5, date 20.12.2006 te KRRTBradashesh

Përshkrimi i projektit teknologjik

Ky projekt përfshin të gjitha të dhënat e informacionet teknike të nevojshme për realizimin e tij si dhe shfrytëzimin e objektit në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në përgjithësi objekti përmban:

- Linjën e Prodhimit të llaceve.
- Linja e prodhimit të ngjyresve
- Sektoret ndihmës si: laborator fiziko kimik, magazina e produktit të gatshëm, parku i mjeteve të transportit; zyrat, dhoma e personelit, sektori i mirembajtjes, kabina elektrike.

Paisjet e fabrikes se prodhimit te kolles, finos dhe stukos jane:

sillose pluhur guri	100m ³	
sillose pluhur mermeri	70m ³	
sillose pluhur gelqeror	70m ³	
sillose pluhur cemento e bardhe	70m ³	
sillose pluhur cemento e gri	70m ³	
shnek ushqimi	10t/ore	L-13m
elevator	10t/ore	H-16
shnek ushqimi	10t/ore	L-13m
shnek furnizimi pluhur guri	Q=15t/ore	L-3,5m
shnek furnizimi pluhur mermeri	Q=15t/ore	L-5m
shnek furnizimi pluhur gelqereje	Q= 8t/ore	L-5m
shnek furnizimi pluhur cemento e bardhe	Q=15t/ore	L-4,5m
shnek furnizimi pluhur cemento gri	Q=15t/ore	L-4,5m
peshore elektronike	P=2,5 T	(cope 2)
rezervuar furnizimi	V=4m ³	(cope 2)
shnek furnizimi	Q=15t/ore	L-12,5m (cope 2)
elevator	Q=15T/ore	L-12,5m (cope 2)
rezervuar furnizimi	V=3m ³	(cope 2)
preres	V=4m ³	(cope 2)
rezervuar protes	V=4m ³	(cope 2)
makine mbushese e thaseve		(cope 2)
shiber pneumatik	(cope 16)	

Lëndët e para:

Pluhur Guri

Me përbërje kryesisht , të gurit gëlqeror CaCO_3 , i karakterizuar nga ngjyrë e bardhë në bezhë.

Analizat e kryera në mostra të gurit gëlqeror të përdorur në procesin e prodhimit, tregojnë për një përmbajtje të :

- CaCO_3 , 47-50%
- MgO , 1-2%
- SiO_2 , 5-7%

Përsa i përket të dhënave fizike-mekanike, rezultojnë këto të dhëna:

- Klasa granulometrike 10-25mm
- Masa specifike e kokrrizave 2.64 g/m³
- Masa vëllimore në gjendje të shkrifët 1420 kg/m³
- Vëllimi i boshllëqeve 46.2 %
- Përcaktimi i ujthithjes 0%
- Përcaktimi i papastërtive 0%
- Kokrriza të petëzuara 4.1%
- Rezistenca në thërrmim 15.33%

Pluhur Mermeri

I cili futet në grupin e mineraleve shkëmborë, për të cilët sot paraqet interes nxjerrja dhe përpunimi i gurëve dekorativë.

Në to bëjnë pjesë gëlqerorët e mermerizuar , dolomitët, dhe mermerët e cimentuar fort.

Ngjyra e tyre varion nga e bardhë, në gri e hapur dhe në disa raste deri në rozë.

Në këtë linjë teknologjike, përpunohen kryesisht copa mermeri, të cilat janë vlerësuar, si mbetje teknologjike në llnjat e përpunimit të mermerit.

Cimento Gri.

Klinkeri i cimentos Portland, është një lëndë që del nga procesi i pjekjes së përzierjes së lëndëve të para minerale , deri në shkrirjen e pjesshme të tyre.

-Karakteristikat kimike të cimentos Portland janë:

- Oksid Kalciumi (CaO) 65.19%
- Oksid Alumini (Al_2O_3) 4.79%

- Oksid Hekuri (Fe_2O_3) 3.51%
- Okside Squfuri (SO_3) 2.65%
- Oksid Magnezi (MgO) 1.88%
- Oksid Natriumi (Na_2O) 0.35%
- Oksid Silice (SiO_2) 19.38%
- Oksid Kaliumi (K_2O) 0.64%
- Mbetja e patretshme 2%
- Humbja në kalcinim 4.30%
- Përmbajtja e Klorit 0.01%

-Karakteristikat fiziko-mekanike:

- Rezistenca në shtypje 2 ditore 26.50 MPa
- Rezistenca në shtypje 7 ditore 39.00 MPa
- Rezistenca në shtypje 28 ditore 50.00 MPa
- Koha e fillimit të mpiksjes Pas 140-150min
- Koha e mbarimit të mpiksjes Pas 195 min
- Zgjerimi 1mm

Cimento e Bardhe

-Karakteristikat Kimike:

- CaO 65.53%
- SiO_2 20.89%
- Al_2O_3 3.18%
- Fe_2O_3 0.23%
- K_2O 0.41%
- Na_2O 0.08%
- SO_3 3.45%
- Humbja në kalcinim 3.36%
- Mbetja e patretshme 0.18%

Karakteristikat Fizike:

- Koha e fillimit të mpiksjes Pas 183min
- Koha e mbarimit të mpiksjes Pas 235min

- Zhvendosja 0.80mm

Karakteristikat kimike dhe fizike, janë sipas Standardit shqiptar S SH EN 197-1 dhe Standardit European EN 197-1.

Gëlqere e Hidratuar Ca(OH)_2

Përftohet në rrugë industrilae apo edhe artizanale.

Guri gëlqeror i nxjerrë nga karierat përkatëse, kalon në procesin teknologjik të pjekjes, në temperatura reaktivisht të larta.

Gjatë këtij procesi, merret gëlqere e pjekur, nëtë cilën përbërës kryesor është Oksidi i Kalciumit Ca O . Duke u future në banjo uji , gëlqeren e pjekur, përftojme atë që njihet me emrin Gëlqere e Hidratuar Ca(OH)_2 , e cila është një lëndë me përmbajtje të lartë uji.

-Të dhënat kimike të Gëlqeres së Hidratuar janë:

- $\text{CaO}+\text{MgO}$ 92.8%
- MgO 0.18%
- CO_2 2.42%
- SO_2 0.04%

-Të dhënat fizike:

- Depërtimi 23%
- Uji i lirë 0.29%
- Zhvendosja 1.15%

Si cimentoja e bardhë, ashtu edhe gëlqerja e hidratuar, janë materiale që vijnë kryesisht nga importi, me tregues cilësorë, të certifikuar sipas Standardeve të vendeve nga ato vijnë apo të Standardeve të BE.

Additivët:

Additivët , janë material që vijnë kryesisht nga importi, shoqërohen gjithmonë me tregues cilësorë të certifikuar, sipas Standardeve të vendeve nga ato vijnë apo Standarde të BE.

- **Celuloza**, me karakteristika të ndryshme, e cila përmirëson performancën e ngjitësave me baze cimentoje, viskozitetin , mbajtjen e ujit, duke rritur kështu kohën e tharjes dhe punueshmërinë e produktit.

-Të dhëna fizike:

- Forma Në trajtë pluhuri
- Tretshmëria E tretshme në ujë
- Viskoziteti 22000-28000 mPa
- PH Neutral
- Përmbajtja e lagështisë 7%

-Fibra celulozike

Janë me baze polimeri akrilik, sigurojnë fortësi, dhe qëndrueshmëri të lartë.

Të dhënat kimike dhe fizike:

- Përmbajtja celulozike 99.5%
- Gjatësia mesatare e fibrave 700µm
- Trashësia mesatare e fibrave 20 µm
- Densiteti 50g/l
- Bardhësia 86%
- Djegshmëria 0.3%
- Vlera e PH 6

Pigmente

- Pigmente inorganike:
- Pigmente me baze karboni
- Pigmente me baze të oksideve të zinkut
- Pigmente me baze të oksideve të hekurit
- Pigmente me baze të oksideve të kromit
- Pigmente me baze të oksideve të bakrit
- Pigmente me bazë dioksid titani

Në fabrikë vijnë të shoqëruara me certifikatën përkatëse të cilësisë, e dhënë nga firmat prodhuese.

Linja teknologjike e prodhimit te llacrave ben perpunimin fizik te lendeve te para dhe ndihmese nepermjet perzjerjes te tyre per marjen e produktit te deshruar. Procesi kalon ne thermim, bluarje, klasifikimi, perzjerja homogjenizuese dhe amabalazhimi.

Lloji i produktit (llacit te kerkuar) behet ne baze te kerkesave qe kane konsumatoret. Duhet thene se te gjitha llojet e llaceve prodhohen ne te njejtin linje teknologjike.

Lendet e para kryesore guri gelqeror dhe mermeri qe vijne nga te tretet depozitohen ne vendet perkatese te depos se lendes se pare te cilat i nenshtrohen procedurave perkatese. Guri gelqeror i cili merret me anen e nje nje kove grejfer dergohet ne bunkerin e lendes se pare i cili ka nje volum $15m^3$. Ne fundin e ketij bunkeri eshte instaluar nje ushqyes elektromagnetik i cili ben te mundur ngarkimin e transportjerit me shirit/rryp gome, ne menyre uniforme gjate gjithe kohes se punes se tij. Ky transportjer me shirit gome me gjeresi 400mm dergon ngarkesen ne kupten +3m, ku gjindet hinka metalike e ushqimit te coptuesit ose mullirit me cekica. Ne kete mulli ose coptues behet bluarja ose thermimi i te gjithe ngarkeses qe kalon neper te, duke e derguar materialin me pas ne nje elevator me shiritit /rryp gome. Mbi gryken e ngarkimit te materialit te coptuesit eshte i vendosur nje sitem aspirimi me filter me minge i cili kap pluhurat dhe ajri i pastruar nepermjet aspiratorit shkarkohet ne oxhakun mbi catine e objektit. Ne menyre periodike behet shkundja ose pastrimi i filtrave me minge nepermjet goditjeve impulsive te ajrit te ngjeshure tyre. Ne kete menyre pluhurat e kapur nga menget e filtrave me ane te nej shneku kalojne ne klasifikator.

Me ndihmen e kovave metalike me vellim rreth $0,05m^3$ cdo njera prej tyre, elevatori e dergon materialin ne klasifikatorin/siten perkatese. Klasifikatori ose sita ben ndarjen ose klasifikimin e materialit te bluar ne disa fraksione, kjo ne varesi te llojit dhe te numurit te rjetave te vendosura ne te. Zakonisht kerkohet ndarja ne 5 fraksione, ne kete menyre ne site vendosen 6 lloje rjetash, me bira standart sipas kerkesave te llojeve te fraksioneve qe duam te marrim.

I gjithe materiali qe mbetet mbi rjeten e pare te sites, me anen e nej shneku metalik shkon ne mullirin me cilindra i cili ben bluarjen perfundimtare te tij. Materiali i bluar ne kete mulli, bie ne ushqyes i cili e dergon ate ne elevatorin qe dergon kete material ne klasifikator/site duke bere nje qarkullim te mbyllur i cili garanton marrjen e te gjitha llojeve te fraksioneve te kerkuar, nga i gjithe materiali fillestar i futur per perpunim, pa lejuar humbje mekanike te sasise se tij. Konstruksioni i sites eshte ndertuar i tille qe te marre cdo lloj fraksioni qe del prej saj(maksimalisht 6 dalje fraksionesh), me ane te shnekeve perkates te cilet kane te njejtin ndertim konstruktiv dhe te njejtin kapacitet transportues. Sejcili shnek e dergon materialin e tij ne nje sillos te percaktuar.

Duhet thene se te gjitha pajisjet qe bejne coptimin apo bluarjen, klasifikimin dhe transportin e materialit, jane te mbyllura me konstruksione metalike dhe guarnicione te gomua me qellim kapjen maksimale te pluhurave si dhe krijimin e nje hermetizimi te mire per te mos krijuar pluhura ne mjediset e punes. Lidhja e konstruksioneve metalike te palevizshme me ato te levizshme behet me ndihmen e pajisjeve amortizuese te gomua, duke mos lejuar daljen e pluhurave. Ne kete menyre, kjo zgjidhje konstruktive si dhe sistemi i aspirimit dhe filtrit me minge, nuk lejojne daljen jashte ketyre pajisjeve te pluhurave te lendeve qe perpunohen, duke mos lejuar humbje mekanike si dhe duke mos krijuar ndotje mjedisore ne vendet e punes dhe ne mjediset e jashtme.

Ne objekt jane vendosur 10 silloze metalike me vellime te ndryshme, ne vartesi kjo nga lloji i materialit qe do te depozitohet dhe do te dozohet. Sillozet e vegjel zakonisht mbajne lende te tilla si cemento te bardhe apo gri(zeze), gelqeren e hidratuar, aditivet apo celulozat, pudrat e ndryshme qe shtohen ne llojin e llacit te kerkuar etj.

Paisjet e linje teknologjike pastrohen kur behet alternimi i lendeve te para, keshtu ne perfundim te perpunimit te sasise te caktuar te gurit gelqeror, pajisjet ndalohen, pastrohen dhe kontrollohet gjendja e tyre teknike dhe linja kalon ne pergatitjen e mermerit ose per perpunimin e nje lende te re.

Cdi silloz eshte i pajisur me nje shnek me tub metalik qe perfundon ne govaten pritesese te nje peshoreje elektronike. Govata mbeshetet ne disa sensore elektro mekanike te cilet percjellin sinjalin qe marrin ne nje njesi elektronike, te programuar e cila ben vleresimin e peshes dhe ne zbatim te programit te dhene, ve ne pune ose ndalon nga puna cdo njerin prej shnekeve qe sjell nje lende te caktuar ne kete govate. Pra ndalimi dhe fillimi i punes behet ne menyre automatike ne funksion te sasie se dozimit qe duhet per cdo lende te pare.

Kur plotesohen sasite e te gjitha lendeve te percaktuar ne nje dozim(perzjere e lendeve te para) atehere zbrazet govata e peshores me ane te shnekut te vendosur nen te, e cila e dergon materialin ne je elevator me shirit/rryp gome te pajisur me kova metalike me vellim $0,03 \text{ m}^3$.

Ky elevator, e dergon materialin ne pajisjen homogjenizuese te ngarkeses e cila perfundon ne nje dozator elektromagnetik. Dozatori eshte i lidhur me nje program me nje peshore elektrike ne te cilen vendoset thesi prej letre i cili do te mbushte me produktin perfundimtar. Ne momentin qe arrihet sasia e programuar 25 kg, dozatori ndalon ne menyre automatike dhe vihet menjehere ne pune pajisja e cila ben mbylljen e qeskes ose thesit prej letre.

Te gjitha keto pajisje dhe aparatura: dozatori, peshorja, pajisja e mbylljes apo qepjes se grykes se qeskes apo thesit prej letre punojne sipas nje programi elektronik te automatizuar. Ne kete menyre realizohet cilesia e sasia e kerkuar sepse sistemi eshte teresisht i mbyllur (pra nuk futen lende te huaja brenda tij dhe nuk lejohet dalje te pluhurave jashte tij), njekohesisht behet nje mbyllje cilesore duke ruajtur marketimin e parapregatitur te ambalazheve.

Ne te gjitha ambjente e punes, te peshimit, homogjenizimit te perzjerjes se materialeve dhe te ambalazhimit eshte instaluar nje sitem aspirimi i cili kap te gjitha pluhurat qe mund te dalin aksidentalisht, pra kemi te bejme me proces teknologjik krejtesisht te mbyllur.

Pas procesit te mbushjes se thaseve ato vendosen ne paletat prej druri duke formuar kub me brinje $1 \times 1 \times 1 \text{ m}$, me qellim qe te konvertohen ne nje peshe pothuajse te pandryshuar nga njera palete tek tjetra. Me anen e nje vinci piru, paletat transportohen ne magazinën e produktit te gatshem ku marketohen , regjistohen dhe jane te gatsheme per tregtim.

Procesi teknologjik i prodhimit te ngjyruesve.

Sasia e prodhimit te ngjyruesve eshte e vogel, keshtu qe dhe numri i makinave eshte me i vogel. Kryesisht ky proces varet nga puna e drejtperdrejt e punetorit.

Punetori ne baze te kerkesave per llojin e ngjyruesit, merre lendet e para kryesore dhe ato shtese dhe i peshon ato vec e vec ne peshore elektronike. Ne nje vellim prej 1 m^3 , punetori per cdo ngjyrues hedhe lenden baze dhe ne vijim pas nje fare kohe te percaktuar sipas kartes teknologjike hedh lendet shtese me anen e se ciles arrihet ngjyra e kerkuar. Ne perfundim te procesit ngjyra e prodhuar amablazhohet ne kova plastike ku i vendosen etiketat perkatese sipas standartit.

Laboratori fiziko kimik

Syri i prodhimit eshte laborator i fiziko kimik. Nepermjet tij hartohet karta teknologjike, nxirren dhe perpunohen mostrat e kampioneve. Te gjitha mostrat e marra i nenshtrohen analizave fizike kimike te cilat shoqerojne produktin e pergatitur.

5. NDIKIMET E MUNDESHME NE MJEDIS DHE MASAT E PROPOZUARA PER PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE

Identifikimi i ndikimeve negative ne biodiversitet.

Nga vete natyra e zones e cila eshte tjetersuar me kohe duke u transformuar totalisht ne nje zone industriale, perjashtohen plotesisht ndikimet ne biodiversitet pasi keto ndryshime kane ndodhur kohe me pare. Ushtrimi i aktivitetit nuk do te kete ndryshime te gjendjes aktuale.

Identifikimi i ndikimeve negative ne peisazh.

Persa i takon ndikimeve peisazhike, mund te permendim se ato gjithashtu do te jene minimale. Objekti ushtron veprimtarine e tij ne nje vend te spostuar dhe shume pak te dukshem nga rruga kryesore. Mynyra e zgjedhjes se konstruksioneve te godinave dhe objekteve te punes si dhe perzgjedhja e formave arkitekturnale, i jep aktivitetit paraqitje prestigjioze dhe ne perputhje me kerkesat e kohes.

Identifikimi i ndikimeve negative nga prodhimi i mbetjeve.

Operacionet	Ndikimi
-Transporti i materialeve dhe vendosja e tyre ne vendet e caktuara, sistemimi dhe operimet per veprimtarine e ushtrimit te aktivitetit te magazinim-tregetimit te materialeve te ndertimit etj.	Krijohen mbetje plastike dhe derrasa qe jane amballazhe materialesh dhe mallrat qe vijne per tu tregetu dhe mbetje te shkaktuara gjate manovrimeve dhe punimeve te ndryshme
- Gjate ushtrimit te aktivitetit te prodhimit	Mbetjet qe kane te bejne me skarcitetet gjate prodhimit do te therrmohen dhe do te riciklohen plotesisht. Mbetjet e krijuara nga demtimet e amballazheve te produkteve dhe qe kane kryesisht karaktere drunjeshore apo plastike, do te grumbullohen ne vende te posacme per tu derguar ne vend depozitimet e tyre.

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT “FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
“GRANITIS”SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

Ndikimi ne toke	Rendesia endikimit
<p>Rilevimi i siperfaqes se tokes per pershtatje per qellime transporti dhe qellime te tjera.</p> <p>Germimi i kanalit te shtrirjes se kabllit per lidhje energji elektrike nga transformatori deri ne objekt.</p> <p>Ngjeshja e tokes si pasoje e transportit te materialeve per efekte furnizimi apo shitje.</p> <p>Erosjoni ne siperfaqet e ushtrimit te veprimtarise dhe siperfaqet e tjera</p> <p>Ndotjet e mundeshme si pasoje e avarive te makinave, derdhje ne mjedis te lubrifikanteve.</p> <p>Vibracjon</p>	<p>I ULET</p> <p>Nuk ka punime ne thellesi.</p> <p>MESATAR Kanali ku eshte shtrihet kablli i tensjonit elektrik si dhe lidhja e paneleve te ushqimit te makinerive e paisjeve.</p> <p>I ULET Infrastruktura rrugore dhe sheshe te ngritura dhe shtruara me beton prevenojne kete efekt.</p> <p>I ULET Nuk ka pjerresira per erozjon.Siperfaqet tokesore jane te sheshta</p> <p>I ULET Vetem ne rast defektesh dhe avari te makinave, ndonje ndikim i vogel dhe i lokalizuar.</p> <p>Do te jene minimale gjate procesit te prodhimit te blloqeve apo pllakave te betonit ne linjen e montuar per kete qellim</p>

Emetimi i zhurmave dhe ndikimet ne ajer.

Ndikimi i mundshem	Rendesia e ndikimit
<p>Emetimi i zhurmave dhe pluhurave si pasoje e operacjoneve teknologjike, atyre te transportit si dhe veprimeve te tjera gjate ushtrimit te aktivitetit.</p>	<p>E ULET</p> <p>Zhurmat e emetuara do te kene disa burime qe renditen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjate ushtrimit te teknologjise se prodhimit te dhe qe presupozon zhurmat e shkaktuara nga puna e paisjeve dhe operacjonet e tjera te ambllazhimit dhe transportit te produkteve. - gjate levizjes se mjeteve teknologjike dhe atyre te transportit. Te gjitha mjetet qe do te bejne furnizimin me lende te para artikujt per tregetim dhe furnizimit Po keshtu te gjitha

<p>Emetimi i gazrave te NOx, SOx, COx, si pasoje e djegies se karburanteve te kamjoneve apo rrjedhjeve te ndryshme te gazit.</p>	<p>mjetet teknologjike ne mbeshtetje te veprimtarise prodhuese makineri teknologjike etj. Pluhur do te kete gjate transportit Ndikimet jane te uleta dhe teper minimale. Nderkohe pluhura ka dhe gjate procesit te prodhimeve por keto jane brenda normave sepse do mbahen ne gadijsmeri pajiosjet dhe sistemi i kapjes se pluhurave.</p> <p>I ULET Do te perdoren mjete motorrike me karburant me djegie te brendeshme dhe kryesisht te reja. Ndikimi do te jete i pa ndjeshem.</p>
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Identifikimi i ndikimeve ne mjedis gjate aktivitetit te linjes se podhimit

NR	Pyetje qe konsiderohen ne fazen e perzgjedhjes	Po /jo	Cilet elemente te mjedisit mund te ndikojne e si	Do te jete ndikimi domethenes ne mjedis Pse
1.A do te perfshije ndertimi,operimi ose mbyllja e veprimtarise dhemontimi i teknologjise dhe paisjeve veprime qe shkaktojne ndryshime fizike ne topografi,perdorim toke,ndryshime ne trupat ujore etj?				
1.1	Ndryshime te perkoheshme ose te perhereshme ne perdorimin e tokes ose topografi duke perfshire rritjen e intesitetit te perdorimit te tokes.	Po	Pjese te tokes ku ushtrohet aktiviteti.	Jo- eshte tjetersu toka ne pjesen ku ushtrohet veprimtaria pasi eshte shtruar me beton e sherben ne vazhdimesi te ushtrimit te teknologjise se prodhimit
1.2	Pastrimi tokes egzistuese, vegjetacionit e ndertimeve egzistuese.	Jo		Jo
1.3	Krijimi perdorimeve te reja te tokes.	Jo		Jo
1.4	Mjedis per magazinim mallrash e materiale.	Po	Nuk ka ndikim ne mjedis.	Jo- ambientet e magazinave dhe vendosjes se linjes teknologjike jane

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT “FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
“GRANITIS”SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

				ndertuar konform rregullave).
1.5	Impiante per trajnim ose depozitim e mbetjeve te ngurta e te lengeshme.	Jo		
1.6	Objekte strehimi te puntoreve shfrytezimit.	Jo		
1.7	Nxjerrje ose transfer. te ujit nga nen toka apo siperfaqet ujore.	Po	Nuk ka ndikim ne mjedis.	Jo. Eshte hapur nje pus uji ne te cilin eshte vendos nje pompe per furnizim per nevoja vetiake
1.8	Ndryshime ne trupat ujore ose ne siperfaqen e tokes qendikojne ne drenimin ose largimin e ujrave.	Jo		Jo
1.9	Transportin e materjaleve te ndertimit, shfrytezimin e mbeturinave.	Po	Nuk do te kete ndikim mjedisor. Behet fjale per transportet e brendeshme qe lidhen me ushtrimin e aktivitetit.	Jo (nuk ka ndikim domethenes.) Mbeturinat qe dalin nga pastrimi i pajisjeve jane periodike,grumbullohen ne nje vend te caktuar per ti derguar me teje per riciklim.
1.10	Punimet afatgjate, cmontimi, nxjerrja e mbeturinave ose punime restauruse.	Jo		Jo
1.11	Veprimtari gjate ndryshimit te destinacionit qe mund te kete ndikim ne mjedis.	Jo		Jo
1.12	Futje per kultivim e specjeve jo vendase.	Jo		Jo
1.13	Humbje te specjeve vendase ose diversitet gjenetik?	Jo		Jo Fenomeni ka ndodhur vite me pare kur tokat jane tjetrsuar
1.14	Ndonje veprim tjetër	Jo		
2. A do perdoren gjate fazes se shfrytezimit burime natyrore te tilla si toka, uji, materiale ose energji, ndonje nga burimet qe jane te parinovushme ose te kufizuara?				
2.1	Toka vecanerisht e varfer apo bujqesore	Po	Tokat jane tjetrsuar duke i dhene tjetër karakter.	Po Tjetrsim i qellimit te tokes duke i kthyer ato ne toka te ushtrim

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT "FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
"GRANITIS"SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

				veprimtarise prodhuese industrialo/ndertimore por pa efekte te ndjeshme mjedisore.
2.2	Uji.	Po	Nuk do te kete ndikim mjedisor Uji sigurohet nepermjet rrjetit te Komunes dhe pusit te hapur nga subjekti brenda teritorit te tije	Jo (sasi e uji per perdorime teknologjik per prodhimet dhe per pastrimet e ambjenteve).
2.3	Minerale?	Jo		Jo
2.4	Grumbullim lendesh ndertimi (inerte etj).	Po	Nuk do te kete ndikim mjedisor pasi jane te vendosura ne vendet e caktuara dhe te mire administruara.	Jo Inertet e dala skarco gjate procesit te prodhimit do te shkermoqen dhe do te riciklohen perseri per prodhim.
2.5	Pyjet dhe lendet drusore	Jo		Jo
2.6	Energji elektrike apo lende djegese.	Po	Nuk do te kete ndikim mjedisore.	Jo (energji elektrike merret nga rrjeti nepermjet nje transformatori te vendosur ne hyrje te objektit per nevojat vetiake).
2.7	Ndonje burim tjetër	Jo		
3. A do te perfshije projekti perdorimin, ruajtien, ranportin, perpunimin dhe prodhimin e substancave ose materialeve qe mund te jene te demshme pershendetin e njeriut ose mjedisin dhe qe rrisin shqetesimin mbi rreziqet aktuale dhe te mundeshme ne shendetin e njerezve?				
3.1	A parashikon projekti perdorimin e substancave ose materialeve te rrezikeshme ose toksike per ambjent?	Jo		Nuk krijohen
3.2	Do te rezultojë projekti ne ndryshim me shfaqje semundjesh ose efekte ne vektoret e semundjeve?	Jo	Ne se nuk perdorem mjetet mbrojtese	Krijohen ne se nuk perdoren mjete mbrojtese
3.3	Do te ndikojë projekti ne mireqenien e njerezve ?	Po	Impakt pozitiv	Hapje vende pune

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT "FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
"GRANITIS"SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

3.4	A ka grupe njerezish qe mund te ndikohen nga projekti p.sh te semure apote moshuar?	Jo		Jo
3.5	Shkaqe te tjera?	Jo		
4. A do te prodhohen mbeturina te ngurta gjate shfrytezimit osa nxjerrjes jasht funksjonit?				
4.1	Mbeturina dherash zhavore ose minierash.	Po	Nuk do te kene ndikim mjedisor.	Jo (pothuajse te gjitha materialet qe dalin skarco apo mbeturine riciklohen ne proces).
4.2	Mbetje urbane (shtepiAKE-tregti).	po	Sasira minimale qe kane te berjne me aktivitetin jetesore te punonjeve te punesuar.	Jo. Mbetjet do te grumbullohen ne koshat e vena per kete qellim dhe do te largohen here pas here per ne vend depozitimin e mbetjeve.
4.3	Mbetje rrezik-toksike apo radia-aktive.	Jo		Jo
4.4	Mbetje te tjera proceseve industriale.	Jo		Jo
4.5	Produkte shtese.	jo		Jo
4.6	Ujra te zeza ose llumra te tjere nga trajtimet e shkarkimeve te lengeta.	Jo		Jane ujra sanitare
4.7	Mbeturina makinash ose paisjesh.	Jo		Pjese metalike riciklohen
4.8	Toka te ndotura apo materiale te tjera.	jo		Jo
4.9	Mbetje bujqesore.	jo		Jo
4.10	Mbetje te tjera te ngyrta.	jo		Jo
5. A dote shkaktohen ndotje ne ajer nga cdo substance tjeter e rrezikshme toksike apo e demeshme per shendetin nga projekti?				
5.1	Shkarkim nga djegia e karburanteve nga burime stacinare te levizeshme.	Po	Gjate operacjoneve te ndryshme qe shoqerohen me perdorim te automjeteve.	Jo. (Gjate ushtrimit te aktivitetit do te kete levizje te mjeteve te transportit dhe atyre teknologjike dhe si rezultat dhe shkarkime nga djegia karburantit nga ana e tyre, por qe ndikimet e tyre do te jene minimale).

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT “FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
“GRANITIS”SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

5.2	Shkarkime nga proceset prodhuese?	jo		Jo
5.3	Shkarkime nga perpunimi i materialeve perfshi depozitimin apo transportin?	Po	Gjate procesit te prodhimit krijohen mbetjet te ngurta te cilat riciklohen	Jo
5.4	Shkarkime nga aktiviteti ndertimit perfshi impiantet dhe paisjet?	Jo		Jo
5.5	Mbetje apo erera sulmuese nga perpunimi i materialeve te ndertimit, ujrat e zeza e mbetjet?	Jo		Jo..
5.6	Shkarkime nga inceneratoret e plehrave?	Jo		Jo
5.7	Shkarkime nga djegia e mbetjeve?	Jo		Jo
5.8	Shkarkimenga burime te tjera	Jo		Jo
6. A do te shkaktoje projekti zhurma dhe vibracjone ose emetime te drites, energjise termike ose rrezatimit elektromanjetik?				
6.1	Nga puna e paisjeve si:motora, paisje prodhimi, ventilues etj?	Po	Nuk do kete ndikime mjedisore dhe do te jene brenda normave te percaktuara per kete qellim.	Po (aktiviteti ushtrohet larg qendrave te banuara.
6.2	Nga procese industriale apo te ngjashme?	Po	Gjate procesit te punes	Jo Gjate ushtrimit te aktivitetit
6.3	Nga ndertime apo prishje?	Jo		Jo
6.4	Nga plasjet apo futje pilotash?	Jo		
6.5	Nga trafiku gjate shfrytezimit?	Po	Nuk ka ndikime mjedisore	Po (Aktiviteti do te ushtrohet larg qendrave te banuara)
6.6	Nga proceset e ndricimit ose ftohjes?	Jo		Jo
6.7	Nga burimet e rrezatimeve elektromagnetike(efektet mbi paisjet dhe njerezit)	Jo		Jo
6.8	Nga cdo burim tjeter?	Jo		
7. A do te coje projekti ne rreziqe te ndotjes se tokes ose ujit nga shkarkimet e ndotesave ne toke ose ne kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza, ujrat siperfaqesore, entokesore, bregdetare, Ose ne det?				
7.1	Nga perpunimi depozitimi perdorim ose shkarkimi materialeve te rrezikeshme e toksike?	Jo		Jo
7.2	Nga shkarkimi i ujrave te zeza ose	Jo		Jo Ujrat e perdorura ne

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT “FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
“GRANITIS”SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

	rrjedhjeve te tjera (trajtuar e patrajtuar)ne uje ose toke?			teknologji per pastrimin e dyshemese do te dekantohen para shkarkimit .
7.3	Depozitimi i ndotesve te shkarkuar ne ajer, uje ose toke	Jo		Jo
7.4	Nga cdo burim tjeter?	Jo		Jo
7.5	A ka rrezik te ndonje akumulimi afat gjate te ndotsave ne mjedis nga keto burime?	Jo		Jo
8. Egziston rreziku i aksidenteve gjate shfrytezimit te projektit qe mund te ndikojne ne shendetin e njerezve apo mjedis?				
8.1	Nga shperthime, zjarre, nxjerrje etj.Nga depozitimi, perdorimi e prodhimi i substancave te rrezikshme e toksike?	Jo		Jo
8.2	Nga ngjarje qe kapercenje kufijt e mbrojties normale te mjedisit, p.sh.demtimi i sistemit te kontrollit te ndotjes?	Jo		Jo
8.3	Nga ndonje shkak tjeter?	Jo		Jo
8.4	Mund te ndikohet projekti nga fatkeqesi natyrore qe shkaktojne deme per mjedisin(permbytje, termete shkarje dheu etj)?	Jo		Jo
9. A rezulton projekti me ndryshime sociale, si p.sh. demografi, mynyre tradicjonale jetese, punesim?				
9.1	Ndryshim ne madhesine e popullsisë moshen, struktur, grupe sociale etj.?	Jo		Jo
9.2	Nga strehimi i njerezve apo prishje e shtepive, mjediseve te komunitetit si shkolla spitale mjedise sociale etj.?	Jo		Jo
9.3	Nepermjet migrimit te banoreve te rinj ose krijimit te komunave te reja?	Jo		Jo
9.4	Nga realizimi i kerkesave ne rritje per mjedisin e sherbimeve sociale si strehim,arsim shendet ?	Jo		Jo
9.5	Nga krijimi i vendeve te punes gjate ndertimit ose shfrytezimit apo humbjes se vendeve te punes me pasoja ne	Po	Impakt pozitiv	Impakt pozitiv nga hapja e vendeve te punes

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT “FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
“GRANITIS”SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

	papunesi e ekonomi?			
9.6	Ndonje shkak tjetër?	Jo		
10. A do te coje projekti ne nje presjon per zhvillim te metejshe me mund te kete ndikim te rendesishem ne mjedis p.sh. me shume banesa, rruge te reja, industri apo veprimtari te tjera mbeshtetese?				
10.1	A do te coje projekti ne presjone per zhvillime te metejshe qe do te kene ndikim te caktuar ne mjedis si: me shume strehime,rruge te reja,industri apo sherbime publike mbeshtetese te reja?	Po	Impakt pozitiv	Jo
10.2	A do te cenoje projekti ne zhvillimin e mjediseve mbeshtetese, ne zhvillime ndihmese ose zhvillime te nxitura nga projekti qe mund te kete ndikim ne mjedis si: 1.Infrastruktura mbeshtetese (rruge, furnizim me energji elektrike, trajtim te mbetjeve ose ujrave te perdorura etj.) 2.Zhvilli i strehimit 3.Industri nxjerrrese (ekstraktuese) 4.Industri furnizuese 5.te tjera	Jo Jo Jo Jo		
10.3	A do te coje projekti ne nje riperdorim te linjes pas shfrytezimit te tije qe do te kete nje ndikim ne mjedis	Jo		Jo
10.4	A do te coje projekti ne krijimin e nje precedenti per zhvillime te mevoneshme	Jo		
10.5	A do te kete projekti pasoja kumulative per shkak te afersise me projekte te tjera egzistuese ose te planifikuara e me pasoja te ngjajshme?	Po	Impakt pozitiv	Po

Masat per zbutjen e ndikimeve gjate fazes se shfrytezimit.

Bazuar ne ndikimin e mesiperme subjekti do te marre masat per kontrollin dhe zbutjen e cdo ndikimi individual. Masat do te jene te karakterit operacional, dhe me veprime konkrete ne mjedis por dhe te karakterit organizativ

Ndikimi ne toke- nuk ka, megjthate do te behet kontrolli periodik

Ndikimi Kimik. -Ndotja e ujrave gjate procesit te larjes dhe pastrimit te objektit. Para shkarkimit te ujrave do te behet dekantimi i tyre dhe nje here ne tre muaj do te behet analiza kimike per permbajtjen e ujrave.

Ndikimi akustik.

Ne pergjithesi, nuk behet fjale per ndotje akustike pasi nuk kemi te bejme me makineri apo paisjete renda qe mund te shkaktojne zhurma mbi normat e lejuara. Mundesi per krijimin e zhurmave mund te jete ne rastet kur behet ngarkim-shkarkimi i materialeve dhe kur ka nderprerje te energjise elektrike zhurma qe mund te shkaktoje gjeneratori i avarise (n.q.s. do te perdoret nje i tille). Po keshtu zhurma shkaktohen dhe ne linjen e prodhimit por ndjeshmeria e tyre kufizohet brenda territorit.

Masat mbrojtese kundra zjarrit.

Zjarri mund te jete prezent ne cdo moment gjate aktivitetit tregtare te magazines. Rreziqet me te mundura jane sidomos ne linjen e magazinimit e materialeve. Per kete qellim ne objekt eshte vendosur nje rezervuare uji me kapacitet 5000 litra dhe furnizimi me uje realizohet me ane te nje pompe me dimensjon 1,5". Ambjentet e magazines mbulohen me hidrante uji

Jane marre masa per vendosjen e sistemit sinjalistik si :

- ndalohet ne mynyre kategorike duhani ne vend magazinimin
- Ndalohet hyrja me mjete ndezese"
- Ndalohet hyrja e personave te pa autorizuar,etj.

Nderkohe realizohet dhe instruksjoni periodik i punonjesve per njohjen e rregullave te sigurimit teknik dhe mbrojties ne pune si dhe ato te M.K.Z.

Magazinat jane te paisura me fikset stabel me shkumbe sipas rregulla qe percakton M.K.Z.

Ndikimet pozitive i aktivitetit.

Artikujt qe tregetohen dhe do te ruhen ne kete magazine do te jene teper cilesore dhe si te tille do te rrisin shkallen e konkurences ne treg duke i dhene gjithmon prioritet rritjes se cilesise se ruajties se tyre. Nderkohe ne magazine mund te ruhen dhe elemente qe importohen. Gama e gjere e prodhimeve qe do te ruhen dhe trajtohen do te pasuroje akoma me shume tregun me keto produkte.

Po keshtu, prodhimtaria lehteson tere zonen dhe me gjere per furnizimin me keto artikuj ndertimore praktike.

Vec sa siper leverdia e objektit konsiston dhe ne gjenerimin e te ardhurave qe do te derdhen ne arken e komunes si rezultat i aktivitetit.

Po keshtu do te punesohet nje numur jo i vogel punonjesish duke i ardhur ne ndihme problemit social te papunesise.

Perputhja e projektit me planet e rregullimit te territorit dhe planet e zhvilimit ekonomik te zones ku do te zbatohet projekti.

Plani i rregullimit te zones.

Teritori i sheshit ku do te zbatohet projekti i perket nje pjese te tokes e kthyer ne truall ndertimi e cila eshte ne pronesi te investitorit dhe administratorit te subjektit. Zona e investimit ndodhet ne

zoneindustriale, pa banesa por qe po merr nje zhvillim progresiv nga dita ne dite, dhe si i tille kerkesat dhe investimet te paraqitura prane Komunes jane te shumta. Keshilli i Rregullimit te Territorit ka dhene vendimin e tij per zbatimin e ketyre kerkesave duke shfrytezuar objektet dhe modifikuar ato me projektet te cilat zbatohen nga aplikantet. Ndertimi dhe zbatimi i ketij projekti eshte nje sherbim me shume per komunitetin e zones .

Plani i zhvillimit ekonomik te zones. Zona industriale qe tashem eshte futur ne territorin e Bashkise Elbasan eshte nje zone e cila ndryshon karakterin e sajë nga dita ne dite, prandaj plani i zhvillimit te zones pervec karakterit bujqesore dhe blektoral po i jep perparësi dhe aplikimit dhe zhvillimin e projekteve per linja dhe punishte me karakter prodhime industriale. Prandaj dhe K.RR.T Bradashesh nuk ka penguar por ka miratuar lejet per aplikime te tilla .

6. PROGRAMI MONITORIMEVE

Ky program do te fokusohet ne mbledhjen e te dhenave mjedisore te veprimtarise se subjektit dhe perdorimin e tyre per permiresimin e mynyres se operimit dhe korigjimit apo marrjen e masave shtese te nevojshme per mbrojtien e mjedisit. Programi i monitorimit te veprimtarise do zbatohet sipas fazave te zbatimit te projektit dhe dote permbaje indikatorët e me poshtem:

- 1.Vezhgimi i elementeve mjedisore (toka, ajer ,uje etj):
- 2.Emetimin e pluhurave;
- 3.Emetimin e zhurmave;
- 4.Emetimin e ndotjeve kimike;
- 5.Rastet e aksidenteve;
- 6.Punime rehabilituese.

EMERTIMI	MASAT	PERGJEGJESI	SHENIME
Ndotjet e ajrit gjate perpunimit te mallrave	-marrja e masave perkatese per minimizimin e ketyre ndotjeve sidomos gjate periudhave te thatesirave te njomen ambjentet e punes here pas here me uje.	Subjekti	Vazhdimisht
Mbetjet gjate ushtrimit te aktivitetit te linjes se	Rigrupimi i tyre dhe riciklimi ne proceset pas ardhies Nderkohe thaset e perdorur duhet te grumbullohen ne nje vend te	Subjekti	Vazhdimisht.Te tilla mbetje per riciklim do te konsiderohen produktet e dala

VNM PARAPRAKE E AKTIVITETIT “FABRIKE E PRODHIMIT TE STUKOS, FINOS, KOLLOS,
(LLACEVE TE THATA) BOJRAVE NGJYRUESE, MATERIALEVE IZOLUESE ETJ -SUBJEKTI
“GRANITIS”SH.A.- INVESTITOR –ISA HYKA

prodhimit	caktuar per ti derguar ne vend grumbullimin e mbetjeve ne mynyre periodike.		skarco duke bere riciklimin e tyre
Dekantimi i ujrave tenologjike	Ujrat qe dalin duhet ti lene te gjitha mbeturinat ne shesh ose ne kanalet anesore te kullimit te tyre.	Subjekti	
Mbetjet gjate proceseve te perpunimit te produkteve qe trajtohen ne magazine si letra, kartona, plasmase amballazhi thase letre te grisura etj.	Per te gjitha mbetjet te dergohen ne vend depozitimin e tyre dhe me teje te largohen per ne vendet e caktuara .	Subjekti	Vazhdimisht
Shkarkime te pluhurit ne atmosfere	Mbajte e gjendjes teknike te paisjeve pluhur kapese duke siguruar hermeticitetit gjate periudhes se kryerjes se funksjonit te tyre. Kontrolli periodi i linjes	Subjekti	Masat e marra shoqerohen me veprime konkrete sic jane: - sherbimi i makinave, zevendesimi i filtrave me minge kur ato demtohen etj

KONKLUSIONE

Nga ushtrimi i ketij aktiviteti tregetare ne fabriken e prodhimit kollit, stukos, finos , ngjyruesve permendim se:

- Aktiviteti zhvillohet ne nje zone qe nuk gezon asnje lloj statusi te vecante mbrojtjeje per vlera mjedisore sipas kerkesave te ligjit te zonave te mbrojtura.
- Aktiviteti zhvillohet ne nje siperfaqe pa probleme konfliktuale pasi eshte nje siperfaqe ne pronesi te subjektit dhe brenda territorit te pronarit te saje.
- Aktiviteti zhvillohet ne nje zone ku relativisht nuk ka zona te banuara dhe zhvillohet ne normalitet te plote dhe nuk sjell shqetesime ne zonen rreth e rrotull.
- Aktiviteti ka mbeshtetje te komunes dhe komunitetit;

- Aktiviteti zhvillohet ne perputhje me kerkesat ligjore dhe vendimeve te Qeverise dhe shtetit Shqiptare duke zbatuar rregullat e vendosura per ruajtien e mjedisit;
- Gjate ushtrimit te aktivitetit trajtohen produkte te cilet nuk perbejne shqetesim per ndotje te mjedisit dhe qe jane te karakterit tregetues;
- Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk demtohen vepra arti, monumentale etj;
- Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk do te kete demtime te flores dhe faunes egzistuese ne zonen ku ushtrohet ky aktivitet;

Nga ana e tije subjekti angazhohet te realizoje cdo lloj punimi rehabilitimi dhe te zbatoje rregullat e duhura ne perputhje me legjislacionin mjedisor duke mbajtur kontakte te vazhdueshme me gjithë organet e specjaluara per te gjitha problemet qe do te hase gjate aktivitetit dhe qe nuk mund te zgjidhen nga ana e saje.

Perfundimisht konkludojme se subjekti ka punuar dhe vazhdon te punoje per te plotesuar sa me mire kerkesat qe lidhen me ruajtie dhe permiresimet e me tejshme te mjedisit duke i kushtuar vemendje te vecante ketij problemi nepermjet planifikimeve te ndermarra dhe atyre te prespektives duke plotesuar ne kete mynyre kushtet per tu paisur me Leje mjedisore.

Eksperte mjedisore

Lila KARAJ